



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 3614/prot.
13

Tiranë, më 30.08 /2021

URDHËR

Nr. 374, datë 30.08.2021

**“PËR HYRJEN E PERSONAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NGA TË
GJITHA PIKAT KUFITARE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, shkronja “a”, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, si edhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot, datë 30.08.2021,

U R D H Ë R O J:

1. Të gjithë personat që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, nga të gjitha pikat kufitare, duke filluar nga data 06.09.2021, duhet të paraqesin një nga dokumentet e mëposhtme:
 - a) Certifikatën e vaksinimit që vërteton vaksinimin e plotë, në formë digjitale apo të printuar apo një dokument i ngjashëm i lëshuar nga autoritetet kompetente shëndetësore vendase që deklaror përfundimin e vaksinimit.
 - b) Test PCR, të kryer brenda 72 orëve përpara nisjes ose testin e shpejtë antigjenik brenda 48 orëve të hyrjes në kufi.
 - c) Dokument të lëshuar nga autoritetet shëndetësore të vendit që provon shërimin nga infeksioni Sars-Cov-2, me vlefshmëri deri në 6 muaj pas shërimit.
2. Dokumentet e kërkuara në pikën 1, të këtij Urdhri, duhet të paraqiten edhe nga personat që kalojnë tranzit në Republikën e Shqipërisë.
3. Përfshirë nga rregullat e përcaktuara në pikën 1 dhe 2, të këtij Urdhri bëhet për fëmijët deri në moshën 6 vjeç.
4. Personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dhe ata persona me leje qëndrimi të përkohshme apo të përhershme dhe që nuk kanë asnjë nga dokumentet e përmendura në pikën 1, të këtij Urdhri, duhet të nënshkruajnë deklaratë në pikën kufitare dhe të vetëizolohen për një periudhë 10 ditore duke informuar autoritetet shëndetësore për të kryer testimin në fund të periudhës së izolimit.

5. Urdhri t'i përcillet Ministrisë përgjegjëse për çështjet e jashtme me qëllim njohjen e tij nga të gjithë përfaqësitë diplomatike në Republikën e Shqipërisë.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, organet kompetente të përcaktuara në Aktin Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së shkaktuar nga Covid-19", i ndryshuar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare".


MINISTRI
Ogerta Manastirliu

REPUBLICA E SHQIPËRIE
SHENDETËSIA
MINISTRIA E SHQIPTARISË
DIPLOMATISIA
EN REPUBLIQUE ALBANA
SANTÉ
LE MINISTRE DES ALBANAIS
DIPLOMATIE